



LËVIZJET EKONOMIKE AFATSHKURTRA



Dhjetor, 2024



PËRMBAJTJA

P Ë R M B L E D H J A.....	2
1. SEKTORI REAL.....	3
Prodhimi industrial	3
Numri i të punësuarve në industri.....	4
Çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor	5
Indekset e qarkullimit në industri	5
Numri i lejeve të lëshuara të ndërtimit dhe vlera e paraparë e objekteve	6
Numri i punëve të kryera ndërtimore sipas llojeve të objekteve.....	7
Qarkullimi në sektorin e tregtisë.....	8
Inflacioni	8
Çmimet e bursës	10
2. SHKËMBIMI I JASHTËM TREGTAR	12
Eksporti	12
Importi	13
Bilanci tregtar	14
Struktura valutore	15
3.SEKTORI FISKAL	15
Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik.....	15
Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë.....	17
4. SEKTORI SOCIAL.....	19
Personat e sapopunësuar dhe personat e regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit	19
Pagat	20
Pensionet	20
5. SEKTORI MONETAR FINANCIAR	21
Paratë primare.....	22
Potenciale i depozitave	22
Kreditë bankare	23
Normat e interesit të depozitave bankare.....	24
Tregu i kapitalit	24
Rezervat devizore	24



P Ë R M B L E D H J A

E L Ë V I Z J E V E M Ë T Ë R Ë N D Ë S I S H M E E K O N O M I K E A F A T S H K U R T R A

dhjetor, 2024

- Në muajin dhjetor të vitit 2024, prodhimi industrial ka shënuar rënie prej 1.4%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak;
- Në muajin dhjetor të vitit 2024, çmimet e shitjes së produkteve industriale të prodhuesve në tregun vendor janë më të larta për 5.3%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar;
- Qarkullimi në industri në muajin dhjetor të vitit 2024, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2023, shënoi rënie për 11.0%;
- Norma e inflacionit në muajin dhjetor të vitit 2024 është 4.4% në nivel vjetor dhe në këtë muaj inflacioni shënon përsheptim rritjeje të lehtë (4.3% në muajin nëntor të vitit 2024). Në nivel mujor, inflacioni shënoi rritje prej 0.3%;
- Në vitin 2024, eksporti shënoi rënie prej 6.5, ndërsa importi rënie prej 0.8, që rezultoi me rritje të deficitit tregtar për 16.1%, krahasuar me vitin 2023;
- Gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2024, realizimi i të hyrave të përgjithshme buxhetore të Buxhetit të RMV-së është 305.622 milionë denarë, që paraqet 96.1% të vlerës së planifikuar për vitin 2024, përkatësisht rritje për 10.3%, krahasuar me të hyrat e realizuara buxhetore, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023;
- Gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2024, realizimi i shpenzimeve të përgjithshme është 347.667 milionë denarë, që paraqet 95.8% të planit vjetor, përkatësisht rritje prej 9.1%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023;
- Në muajin dhjetor të vitit 2024, kreditë e përgjithshme të bankave janë rritur për 11.2%, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2023, ndërsa potenciali i përgjithshëm i depozitave të bankave ka shënuar rritje prej 12.4%.



1. SEKTORI REAL

Prodhimi industrial



Në muajin dhjetor të vitit 2024, prodhimi industrial ka shënuar rënie prej 1.4%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar. Rënia vjen si rezultat i rënies së prodhimit në të gjithë sektorët, si në atë të sektorit të minierave dhe gurorëve për 10.0%, industrinë e përpunimit për 1.1%, ndërsa sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar shënoi rritje për 5.7%.



Rritje të prodhimit në muajin dhjetor të vitit 2024, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2023 shënojnë 15 degë industriale prej 27 degëve të përgjithshme, të cilat përfshijnë 50.1% të industrisë së përgjithshme.

Nga degët me vlerë të shtuar më të lartë, në muajin dhjetor të vitit 2024 rritje kanë shënuar këto degë: prodhimi i pajisjeve elektrike prej 19.3% me kontribut prej 1.0 p.p. dhe prodhimi i metaleve prej 14.0% me kontribut prej 0.6 p.p., ndërsa rënie kanë shënuar degët në vijim: prodhimi i automjeteve, rimorkiove dhe gjysmë-rimorkiove prej 23.1% me kontribut prej -3.0 p.p. dhe prodhimi i makinerive dhe pajisjeve prej 26.9% me kontribut prej -1.7 p.p..

Nga degët tradicionale në muajin dhjetor të vitit 2024, shënohet rritje e prodhimit në degët e mëposhtme: industria e produkteve ushqimore për 0.6, me kontribut prej 0.1 p.p., prodhimi i pijeve për 26.2 p.p. dhe me kontribut prej 0.9 p.p., prodhimi i lëkurës për 6.7 me kontribut prej 0.0 p.p. dhe prodhimi i produkteve të duhanit për 121.6% me kontribut prej 1.5 p.p., ndërsa vërehet rënie në këto degë: përpunimin e drurit dhe produkteve të drurit dhe tapës për 20.5% me kontribut prej -0,1 p.p., prodhimi i veshjeve për 6.3% me kontribut prej -0,4 p.p. dhe prodhimi i tekstileve për 2.7% dhe me kontribut prej -0.1 p.p..

Prodhimi industrial sipas destinimit të njësive prodhuese në muajin dhjetor të vitit 2024, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2023 është ulur vetëm në grupin e prodhimeve kapitale (rënie prej 20.1% me kontribut prej -0.4 p.p.), ndërsa prodhimi është rritur te këto grupe: energjia (rritje prej 2.4% me kontribut prej 0.3 p.p.), produktet intermediare, përveç energjisë (rritje prej 3.7% me kontribut prej 1.1 p.p.), produktet me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë (rritje prej 14.7% me kontribut prej 0.5 p.p.) dhe produktet me afat të shkurtër skadence për konsum të gjerë rritje prej 4.9% me kontribut prej 1.5 p.p..






Sipas destinimit të njësive prodhuese, rritje gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2024 është regjistruar vetëm në grupin e produkteve me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë (për 10.5%), ndërsa rënie shënohet në grupet e mëposhtme: energjia (për 16.7%), produktet intermediare përveç energjisë (për 1.4%), produktet kapitale (për 1.6%) dhe produktet me afat të shkurtër skadence për konsum të gjerë (për 3.3%).

Numri i të punësuarve në industri

Në muajin dhjetor të vitit 2024, numri i të punësuarve në industri ka shënuar rënie prej 4.7%, krahsuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia vjen për shkak të numrit të reduktuar të të punësuarve në të gjithë sektorët: minierat dhe guroret për 1.6%, industria e përpunimit për 5.0% dhe furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 2.5%. Rritje të numrit të të punësuarve vërehet në këto degë: prodhimi i makinerive dhe pajisjeve, të paspecifikuara diku tjetër për 36.0%, prodhimi i pijeve për 8.7% dhe prodhimi i produkteve farmaceutike bazë dhe preparateve farmaceutike për 8.2%.



Të dhënat për numrin e të punësuarve në industri sipas grupeve të destinimit në muajin dhjetor të vitit 2024, krahsuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, tregojnë se rritje e numrit të të punësuarve shënon vetëm grupi i produkteve me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë për 25.7%.


Të dhënat kumulative tregojnë se numri i të punësuarve në industri gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2024 shënoi rënie për 0.3% si rezultat i uljes së numrit të të punësuarve në sektorin e industrisë së përpunimit për 0.6%, ndërsa rritje regjistrohet në këto sektorë: minierat dhe guroret për 4.5% dhe furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 0.6%.

Sa i përket grupeve të destinuara, numri i të të punësuarve në industri gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2024 ka shënuar rritje në sektorët: energjia për 3.8%, produkte kapitale për 10.3% dhe produktet me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë për 16.8%.




Çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor

Në muajin dhjetor të vitit 2024, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor ishin për 5.3% më të larta, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja vjen si pasojë e rritjes së çmimeve në sektorët: industria e përpunimit për 3.9%, furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 14.0% dhe furnizimi me ujë; trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e përmirësimit të mjedisit për 4.5%, ndërsa në sektorin e minierave dhe guroreve çmimet e shitjes u ulën për 0.6%.



Në muajin dhjetor të vitit 2024, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2023, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor janë më të larta në grupet: energjia për 12.9%, produktet e konsumit të gjërë për 7.7%, produktet me afat të gjatë skadence për 2.9% dhe produktet me afat të shkurtër skadence për 7.9%.



Në bazë kumulative, në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor janë më të larta për 2.4%, kjo vjen si pasojë e rritjes së çmimeve në sektorët: industria e përpunimit për 1.6%, furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 7.4% dhe furnizimi me ujë; trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e përmirësimit të mjedisit për 3.1%, ndërsa çmimet e shitjes u ulën në sektorin e minierave dhe guroreve për 1.1%.

Në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024 krahasuar me janar - dhjetor të vitit 2023, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor janë më të larta në grupet: energjia për 6.9%, produkte të konsumit të gjërë për 6.1%, produkte me afat të gjatë skadence për 4.2% dhe produkte me afat të shkurtër skadence për 6.1%.

Indekset e qarkullimit në industri

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, qarkullimi në industri në muajin dhjetor të vitit 2024 është ulur për 11.0% krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2023. Rënia vjen si pasojë e uljes së qarkullimit në sektorin e industrisë së përpunimit për 11.9%, ndërsa qarkullimi në sektorin e minierave dhe guroreve është rritur për 15.9%.



Në muajin dhjetor të vitit 2024, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2023, qarkullimi në industri është rritur në grupet: produktet me afat të gjatë skadence për konsum të gjërë për 8.2% dhe produktet me afat të shkurtër skadence për konsum të gjërë për 1.3%.

Degët me rritjen më të lartë të qarkullimit në industri në muajin dhjetor të vitit 2024, krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar janë:




- Prodhiimi i pajisjeve të tjera të transportit (ritje prej 64.3%);
- Minierat dhe guroret (ritje prej 37.2%) dhe
- Prodhiimi i produkteve kompjuterike, elektronike dhe optike (ritje prej 16.0%).

Në bazë kumulative, në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, qarkullimi në industri është ulur për 10.8%, që vjen si pasojë e rënies së qarkullimit në sektorin e industrisë së përpunimit për 11.2%, ndërsa qarkullimi në sektorin e minierave dhe guroreve shënon rritje prej 2.3%.

Në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024, krahasuar me periudhën janar - dhjetor të vitit 2023, qarkullimi në industri është rritur në grupet: produktet me afat të gjatë skadence për konsum të gjërë për 3.4% dhe produktet me afat të shkurtër skadence për konsum të gjërë për 1.1%.

Numri i lejeve të lëshuara të ndërtimit dhe vlera e paraparë e objekteve

Në muajin dhjetor të vitit 2024 janë lëshuar gjithsej 287 leje ndërtimi, që paraqet rënie prej 2.0% krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2023. Kjo vjen për shkak të rënies vjetore të lejeve të lëshuara të ndërtimit për objektet nga rikonstruimi për 8.6% (të cilat përbëjnë 22.3% të numrit të përgjithshëm të lejeve të lëshuara ndërtimit), ndërsa te objektet e ndërtimeve të larta ka rritje për 31.6%. Krahasuar me muajin nëntor të vitit 2024, numri i lejeve të lëshuara të ndërtimit është rritur për 10.4%. Vlera e parashikuar e objekteve sipas lejeve të lëshuara të ndërtimit në muajin dhjetor të vitit 2024 është për 22.6% më e ulët në bazë vjetore dhe krahasuar me muajin paraprak ka shënuar rritje për 16.6%.





Analizuar sipas llojit të objekteve, nga numri i përgjithshëm i lejeve të lëshuara të ndërtimit, 175 (ose 61.0%) janë të destinuara për objektet e ndërtimeve të larta, 48 (ose 16.7%) për objekte për rikonstruim.

Analizuar sipas llojit të investitorëve, nga gjithsej 287 leje të lëshuara ndërtimi, 157 objekte (ose 54.7%) si investitorë janë personat fizikë, ndërsa 130 objekte (ose 45.3%) si investitorë janë subjektet afariste.

Me lejet e lëshuara të ndërtimit në muajin dhjetor të vitit 2024 parashikohet ndërtimi i 705 banesave me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme prej 59.557 m². Numri i banesave të planifikuara për ndërtim është rritur për 30.1% në nivel mujor dhe për 60.6% në nivel vjetor.



Numri i punëve të kryera ndërtimore sipas llojeve të objekteve

Vlera e përgjithshme e punëve të kryera ndërtimore në muajin nëntor të vitit 2024 arriti në 4.331 milionë denarë, që paraqet rritje nominale vjetore prej 17.3%, ku rritje ka në ndërtimet e larta për 12.4%, në ndërtimet e ulëta për 21.7%, ndërsa në punimet e specializuara të ndërtimit ka rënie prej 23.9%. Krahasuar me muajin tetor të vitit 2024, vlera e përgjithshme e punëve të kryera ndërtimore ka pasur rritje për 19.6%, si në ndërtimet e larta për 4.3%, ashtu edhe te ndërtimet e ulëta për 26.2% dhe në punimet e specializuara ndërtimore për 19.3%. Në mënyrë kumulative, në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, vlera e punëve të kryera ndërtimore arriti në 31.627 milionë denarë, që është 8.9% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në kuadër të punëve të kryera ndërtimore, pjesa më e madhe i referohet ndërtimit të ndërtesave të ulëta, ku në dhjetë muajt e parë të vitit janë kryer punë ndërtimore në vlerë prej 20.352 milionë denarëve, përkatësisht 21.9% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë kësaj periudhe, vlera e punëve të

kryera në ndërtimin e ndërtesave të larta është ulur për 9.8% dhe ka vlerë prej 10.240 milionë denarëve, ndërsa në punimet e specializuara ndërtimore vlera e punëve të kryera është 1.036 milionë denarë, gjegjësisht 4.2% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në bazë reale, vlera e punimeve të kryera ndërtimore në periudhën janar - nëntor të vitit 2024 është rritur për 17.5%, me rritje në ndërtimin e ndërtesave të ulëta (31.6%) dhe punimeve të specializuara ndërtimore (12.5%), ndërsa në ndërtimet e ndërtesave të larta është shënuar rënie prej (2.8%).






Qarkullimi në sektorin e tregtisë

Në muajin dhjetor të vitit 2024, të dhënat e tregtisë së brendshme tregojnë rritje nominale vjetore të qarkullimit prej 4.9%, pas rritjes prej 3.0% në muajin nëntor. Vlera e qarkullimit në muajin dhjetor të vitit 2024 është 74.634 milionë denarë, ndërsa në mënyrë kumulative, në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024, vlera e qarkullimit të përgjithshëm tregtar arriti në 802.082 milionë denarë, që është 4.5% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Kumulativisht, në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024, rritje pozitive e qarkullimit është shënuar në të gjithë sektorët: tregtia me shumicë, vlera e qarkullimit të së cilës është 434.507 milionë denarë, përkatësisht 5.8% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, tregtia me pakicë, vlera e qarkullimit të së cilës është 319.277 milionë denarë, që është 3.5% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, dhe tregtia me automjete motorike dhe riparime, me ç'rast vlera e qarkullimit është 48.298 milionë denarë ose 0.6% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në bazë reale, në muajin dhjetor të vitit 2024, tregtia me pakicë shënoi rritje vjetore prej 3.6%, ndërsa analizuar sipas grupeve dhe klasave, rritje është shënuar në grupin e tregtisë me pakicë të produkteve joushqimore për 8.4%, tregtisë me pakicë të karburanteve të automobilave për 1.1% dhe tregtisë me pakicë të ushqimeve, pijeve dhe duhanit për 0.1%.


Në muajin dhjetor të vitit 2024, pjesëmarrje më të madhe strukturore në sektorin e tregtisë kishte njësia e tregtisë me shumicë (53,9%), ndjekur nga tregtia me pakicë (40,0%) dhe tregtia e automjeteve dhe motoçikletave, riparimit dhe mirëmbajtjes së tyre (6.1%).



Inflacioni

Norma e inflacionit në muajin dhjetor të vitit 2024 është 4.4% në nivel vjetor dhe ajo gjithashtu regjistroi përsheptim të lehtë të rritjes këtë muaj (4.3% në muajin nëntor të vitit 2024). Rritja e inflacionit këtë muaj në masë të madhe rezulton nga komponenti ushqimor, i cili dy muajt e fundit shënoi rritje të përsheptuar dhe rritje të kontributit në inflacionin e përgjithshëm, ndërkohë që komponenti bazë shënoi stagnim të rritjes në muajin dhjetor. Norma e inflacionit për vitin 2024 është 3.5%.


Inflacioni bazë (inflacioni pa ndikimin e çmimeve të ushqimeve dhe energjensave) në muajin dhjetor të vitit 2024, mbeti i pandryshuar në krahasim me muajin paraprak dhe shënon 5.5 në nivel vjetor (5.4 në muajin nëntor). Kontribut më të





madh pozitiv këtë muaj ka pasur rritja e çmimeve në kategorinë e restoranteve dhe hotelerisë (1.4 p.p.).


Çmimet në kategorinë e produkteve ushqimore dhe pijeve joalkoolike, këtë muaj ishin 5.6% dhe shënuan përshpejtim të lehtë të rritjes në krahasim me muajin paraprak (5.7 në muajin nëntor), me ç'rast kontributi i kësaj kategorie në inflacionin e përgjithshëm në muajin dhjetor është 2.3 p.p. dhe kontributi i tij mbeti i pandryshuar në krahasim me muajin e kaluar. Kontributin më të madh pozitiv në rritjen e kategorisë së produkteve ushqimore dhe pijeve joalkoolike kishin nënkategoritë: perimet (rritje vjetore prej 12.7% dhe kontributi prej 0.6 p.p), qumështi, djathi dhe vezët (rritje vjetore prej 7.5%, kontributi prej 0.6 p.p), mishi (rritje vjetore prej 4.0%, kontributi prej 0.4 p.p.), pijet joalkoolike (rritje vjetore prej 13.6%, kontributi prej 0.4 p.p) dhe buka, drithërat dhe vaji të gjitha me kontribut prej 0.2 p.p.



Shikuar sipas komponentëve, rritja më e lartë vjetore e çmimeve në muajin dhjetor të vitit 2024 u shënuar në kategorinë e restoranteve dhe hoteleve për 12.1% (kontributi në rritjen e inflacionit të përgjithshëm prej 0.7 p.p).

Rritje të çmimeve janë regjistruar edhe në këto kategori: pijet alkoolike, duhani dhe lëndët narkotike prej 6.6%¹, rekreacioni dhe kultura prej 5.7%, mbrojtja shëndetësore prej 4.4%, mallrat dhe shërbimet e ndryshme prej 4.2%, mobilje, pajisje elektroshtëpiake dhe mirëmbajtje të rregullt shtëpiake prej 2.7%, kategoria e veshjeve dhe këpucëve prej 2.4%, komunikimet prej 2.0%, transporti prej 1.6%, banimi, uji, rryma, gazi dhe lëndët e tjera djegëse prej 0.6% dhe arsimit prej 0.3%.

Çmimet e konsumit në muajin dhjetor u rritën për 0.3% në nivel mujor (çmimet në muajin e kaluar u rritën për 0.7%). Rritja e çmimeve në nivel mujor vjen si pasojë e rritjes së çmimeve në kategorinë e transportit që u rrit për 4.8% me kontribut pozitiv prej 0.4 p.p., me ç'rast rritja është si rezultat i rritjes së çmimeve në komunikacionin ajror për shkak të ndikimit sezonal.



Në muajin dhjetor, çmimet e produkteve ushqimore janë ulur prej 0.3% në nivel mujor dhe me kontribut negativ prej 0.1 p.p., që pjesërisht i detyrohet masës për uljen e marzheve për disa produkte ushqimore, e ashtuquajtura “Shporta e Vitit të Ri”, e cila ka hyrë në fuqi më datë 15.12.2024.

¹Çmimi i produkteve të duhanit është rritur në përputhje me ndryshimet e miratuara në Ligjin e Akcizave, akciza e cigareve do të rritet për 0.23 denarë për copë çdo vit deri në vitin 2030. Në muajin tetor të vitit 2024 u vendos çmimi i ri i duhanit.



Në muajin dhjetor të vitit 2024 çmimet me pakicë janë rritur për 4.3% në nivel vjetor dhe ato shënojnë përsheptim rritjeje. Në bazë mujore, çmimet me pakicë kanë regjistruar rritje prej 1.2%. Në vitin 2024, çmimet me pakicë janë rritur me 3.8 në nivel vjetor.

Në Eurozonë, norma e inflacionit në muajin dhjetor të vitit 2024 u rrit për 0.2 p.p. krahasuar me muajin nëntor dhe është 2.4%².


Sipas projeksioneve të BQE-së, nga muaji shtator i vitit të kaluar, norma e inflacionit në vitin 2024 do të arrijte në 2.5%, 2.2% në vitin 2025 dhe 1.9% në vitin 2026.

Çmimet e bursës


Në muajin dhjetor të vitit 2024, çmimi i naftës bruto (brent) në bursat botërore u ul për 0.8% në nivel mujor dhe ishte 74.4 dollarë për fuçi, për shkak të kombinimit të shumë faktorëve, përkatësisht rritjes së furnimizimit nga vendet që nuk janë pjesë e OPEK +, shqetësimi për rritjen ekonomike globale, veçanërisht në Kinë, që shënoi ulje të kërkesave të naftës, si dhe faktorëve gjeopolitikë. Në nivel vjetor çmimi i naftës është më i ulët për 5.2%.

Në muajin dhjetor të vitit 2024, çmimi i gazit natyror është rritur për 10.6% në nivel mujor. Çmimi i gazit është nën ndikimin e disa faktorëve, mes të cilave edhe të tensioneve gjeopolitike, përfshirja dhe eskalimi i konfliktit në Lindjen e Mesme dhe shqetësimit për ndërprerjen e mundshme të furnizimit në kufirin ruso-ukrainas për shkak të konfliktit të vazhdueshëm. Këta faktorë kanë rritur shqetësimin në tregun e gazit, me ç'rast rritet jostabiliteti. Në muajin dhjetor të vitit 2024, çmimi i gazit natyror u ul për 20.4% në nivel vjetor.


Çmimi i energjisë elektrike në muajin dhjetor të vitit 2024 sipas Bursës Hungareze të Energjisë Elektrike (HUPX) ishte 143.86 euro për megvat/orë dhe në nivel mujor u regjistrua rritje prej 12.1%. Çmimet e energjisë elektrike shënuan ulje në



Burimi: Banka Botërore; përllogaritjet e MF-së



Burimi: Banka Botërore; përllogaritjet e MF-së



Burimi: Banka Botërore

² Të dhënat janë vlerësim i Eurostat-it



muajin dhjetor pas rritjes në muajt e mëparshëm, për shkak të rritjes së çmimit të gazit natyror, rritjes së kërkesës për shkak të kushteve atmosferike dhe rënies së prodhimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Në muajin dhjetor, çmimi i energjisë elektrike u rrit për 76.1% në nivel vjetor.

Në muajin dhjetor të vitit 2024, çmimet e metaleve bazë regjistruan ulje krahasuar me muajin paraprak, si për shembull ulje shënuan çmimet e: kallait për 2.7%, nikelit dhe bakrit për 1.8% dhe aluminit për 1.6%. Çmimet e zinkut dhe plumbit janë rritur përkatësisht për 1.0% dhe 0.1%.

Këtë muaj edhe çmimet e metaleve të çmuara regjistruan ulje në nivel mujor, si për shembull çmimi i arit u ul për 0.1%, argjendit për 1.1% dhe platinë për 2.9%.

Në muajin dhjetor, çmimi i misrit dhe grurit u rrit respektivisht për 0.6%, dhe 0.4%. Çmimi i vajit të lulediellit u rrit për 3.5% në nivel mujor.

Tabela 1.1. Çmimet e energjensave në bursa (të dhëna mujore)

	Energjia elektrike (EUR/MWh)	Nafta bruto, Brent (\$/bbl)	Gazi natyror, Evropë (\$/1000 m3)
2023 I	148,7	83,1	714,1
II	146,2	82,7	585,1
III	113,4	78,5	488,7
IV	106,7	84,1	478,4
V	88,2	75,7	357,7
VI	96,6	74,9	366,2
VII	94,5	80,1	337,2
VIII	100,4	86,2	396
IX	103,8	94,0	408,6
X	104,9	91,1	515,5
XI	99,38	83,2	512,5
XII	81,72	77,9	407,1
2024 I	85,73	80,2	338,2
II	69,35	83,8	288,3
III	65,12	85,5	302,6
IV	61,96	90,5	321,4
V	72,2	82,0	358,2
VI	91,7	82,6	384,6
VII	135,5	85,3	366,1
VIII	120,8	80,9	437,8
IX	106,1	74,3	416,94
X	92,2	75,7	457,1
XI	163,7	74,4	492,7
XII	143,9	73,8	490,3


Burimi: Banka Botërore, Bursa Hungareze e Energjisë Elektrike (World Bank, Hungarian Power Exchange)/



2. SHKËMBIMI I JASHTËM TREGTAR

Shkëmbimi i jashtëm tregtar i përgjithshëm në vitin 2024 ishte 18.843,6 milionë euro, me ç'rast shënoi rënie prej 3.2% krahasuar me vitin 2023.


Në vitin 2024, pjesëmarrja e shkëmbimit të jashtëm tregtar me Bashkimin Evropian (BE 27), si partneri më i madh tregtar është ulur për 0.4 p.p, krahasuar me vitin paraprak dhe shënon 61.4%. Gjermania është partnerja më e rëndësishme tregtare e vendit tonë. Në strukturën e përgjithshme të shkëmbimit të jashtëm tregtar të vendit tonë, pjesëmarrja e shkëmbimit tregtar me Gjermaninë në vitin 2024 ishte 22.8% dhe është ulur për 2.0 p.p., krahasuar me vitin 2023.



Eksporti

Vlera e mallrave të eksportuara në vitin 2024 ishte 7.781,2 milionë euro dhe shënoi rënie prej 6.5% (541.6 milionë euro), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, ndërsa vëllimi fizik i eksportit u rrit për 0.1%, krahasuar me vitin paraprak.

Vlera e mallrave të eksportuara në muajin dhjetor të vitit 2024 ishte 564.6 milionë euro dhe shënoi rënie prej 14.2% (93.7 milionë euro), krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa vëllimi fizik i eksportit u ul për 3.1%, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2023.




Analizuar në nivel mujor, në muajin dhjetor të vitit 2024, eksporti shënoi rënie prej 13.5% (88.0 milionë euro), krahasuar me muajin paraprak, edhe pse po kryhen rregullime sezonale të eksportit, ku ai regjistroi rënie mujore prej 4.8%, që do të thotë ndikim negativ të faktorit sezonal (8.7 p.p.) kundrejt eksportit të këtij muaji.

Vlera e eksportit të produkteve ushqimore në vitin 2024 është rritur për 52.3 milionë euro, që do të thotë rritje prej 10.6% krahasuar me vitin 2023, ndërsa sasia e eksportuar e produkteve ushqimore ka shënuar rritje për 11.7%. Në strukturën e përgjithshme të eksportit në vendin tonë, pjesëmarrja e produkteve ushqimore në vitin 2024 është 7.0% dhe është rritur për 1.1 p.p. krahasuar me vitin 2023. Në eksportin e përgjithshëm të produkteve ushqimore, pjesëmarrjen më të madhe të eksportit e kanë produktet e mëposhtme: frutat dhe perimet (46.1%), drithërat dhe produktet e drithërave (22.8), mishi dhe produktet e mishit (7.5%), kafeja, çaji, kakaoja dhe erëzat (6.8%)





Analizuar sipas grupimeve ekonomike³ të vendeve, në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, eksporti ka shënuar rënie në këto grupime: BE 27, EFTA, Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës dhe Derivateve të Naftës, Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik nga Rajoni i Azisë - Paqësorit dhe rritje në grupimet: Ballkani Perëndimor, Zona e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut dhe Bashkësia e Shteteve të Pavarura. Eksporti në 27 vendet e BE-së pësoi rënie prej 8.7% në nivel vjetor dhe paraqet 76.9% në eksportin e përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa eksporti në vendet e Ballkanit Përqendimor shënoi rritje prej 6.0% dhe paraqet 14.3% të eksportit të përgjithshëm në vendin tonë.



Importi

Vlera e mallrave të importuara në vitin 2024 ishte 11.062,4 milionë euro dhe shënoi rënie prej 0.8% (86.1 milionë euro) krahasuar me vitin 2023, ndërsa vëllimi fizik i importit shënoi rënie prej 5.3%.

Vlera e importit në muajin dhjetor të vitit 2024 ishte 935,3 milionë euro dhe shënoi rënie prej 2.6% (24.5 milionë euro), krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2023, ndërsa sasia e mallrave të importuara u rrit për 0.1%, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2023.



³Grupimet ekonomike përfshijnë vendet e mëposhtme: BE 27 (Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Republika Çeke, Gjermania, Danimarka, Estonia, Spanja, Finlanda, Franca, Greqa, Hungaria, Irlanda, Italia, Lituania, Luksemburgu, Letonia, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Suedia, Sllovenia dhe Sllovakia); EFTA (Zvicra, Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia); Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës dhe Derivateve të Naftës (Emiratet e Bashkuara Arabe, Angola, Algjeria, Ekuadori, Iraku, Irani, Kuvajti, Libia, Nigeria, Katari, Arabia Saudite dhe Venezuela); Ballkani Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia); Zona e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut (Kanada, Meksika dhe SHBA-ja); Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik Azi-Paqësor (Australia, Brunei, Kanada, Kili, Kina, Hong Kongu, Indonezia, Japonia, Koreja, Meksika, Malajzia, Zelanda e Re, Peruja, Papua Guinea e Re, Filipinet, Rusia, Singapori, Tajlanda, Tajvani, SHBA-ja dhe Vietnam) dhe Bashkësia e Shteteve të Pavarura (Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Kirgistani, Kazakistani, Moldavia, Rusia, Taxhikistani, Turkmenistani, Ukraina dhe Uzbekistani).



Analizuar në nivel mujor, në muajin dhjetor të vitit 2024, importi shënoi rënie prej 0.2% (1.8 milionë euro) krahasuar me muajin paraprak dhe nëse ndryshohen kuotat e importit në aspektin sezonal, ai shënon rënie mujore prej 1.6%, që tregon ndikimin pozitiv të faktorit sezonal (1.4 p.p.) mbi importin këtë muaj.

Vlera e importit të produkteve ushqimore në vitin 2024 është rritur për 91.5 milionë euro, që paraqet rritje prej 9.4, krahasuar me vitin 2023, ndërsa sasia e produkteve ushqimore të importuara u rrit për 6.5%. Në vitin 2024, pjesëmarrja e produkteve ushqimore në strukturën e importit të përgjithshëm në vendin tonë është 9.6% dhe është rritur për 0.9 p.p., krahasuar me vitin 2023. Në importin e përgjithshëm të produkteve ushqimore, pjesëmarrje më të madhe ka importi i produkteve në vijim: mishi dhe produktet e mishit (21.6%), frutat dhe perimet (15.1%), drithërat dhe produktet e drithërave (13.3%), kafja, çaji, kakaoja dhe erëzat (11.8%), si dhe produktet e qumështit dhe vezët (9.8%).

Tabela 2.1. Pasqyra e eksportit dhe importit të produkteve të grupeve të përzgjedhura


Eksporti i naftës dhe produkteve të naftës*)					Im porti i naftës dhe produkteve të naftës*)				
	I-X II-2023	I-X II-2024	Saldo	Norm at në %		I-X II-2023	I-X II-2024	Saldo	Norm at në %
000 T	128,9	115,3	-13,6	-10,6	000 T	1.190,8	1.165,8	-25,0	-2,1
Mil. EURO	101,2	81,3	-19,9	-19,7	Mil. EURO	876,1	805,8	-70,3	-8,0
Mil. \$	109,4	87,9	-21,5	-19,7	Mil. \$	947,4	872,3	-75,1	-7,9
*)Të dhënat paraprake									
Eksporti i produkteve kimike*)					Im porti i produkteve kimike*)				
	I-X II-2023	I-X II-2024	Saldo	Norm at në %		I-X II-2023	I-X II-2024	Saldo	Norm at në %
000 T	77,7	65,6	-12,2	-15,7	000 T	30,8	32,6	1,8	5,7
Mil. EURO	2.392,5	1.815,7	-576,8	-24,1	Mil. EURO	189,7	174,1	-15,6	-8,2
Mil. \$	2.587,6	1.966,6	-621,0	-24,0	Mil. \$	205,1	188,4	-16,7	-8,2
*)Të dhënat paraprake									
Eksporti i hekurit dhe çelikut*)					Im porti i hekurit dhe çelikut*)				
	I-X II-2023	I-X II-2024	Saldo	Norm at në %		I-X II-2023	I-X II-2024	Saldo	Norm at në %
000 T	654,3	653,9	-0,4	-0,1	000 T	673,8	687,4	13,5	2,0
Mil. EURO	572,6	501,4	-71,2	-12,4	Mil. EURO	495,5	472,0	-23,6	-4,8
Mil. \$	619,1	543,4	-75,7	-12,2	Mil. \$	535,3	510,9	-24,4	-4,6
*)Të dhënat paraprake									

Bilanci tregtar

Në vitin 2024, deficitin tregtar u rrit për 16.1%, ose 455.5 milionë euro, krahasuar me vitin 2023.

Në dhjetor të vitit 2024, deficitin tregtar u rrit për 23.0%, përkatësisht 69.2 milionë euro, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2023.

Nëse analizojmë saldona e eksportit dhe importit të mallrave sipas destinimit ekonomik, rritja e deficitit është rezultat i rritjes së deficitit në shkëmbim me furnizimet industriale, mallrave të konsumit të produkteve ushqimore dhe pijeve, si dhe nga zvogëlimi i saldosa pozitive në shkëmbim me pajisjet e transportit. Nga ana tjetër, në uljen e saldosa





negative ka ndikuar ulja e deficitit në shkëmbimin me lëndët djegëse dhe lubrifikantët dhe mallrat për investime, pa përfshirë pajisjet e transportit.

Në vitin 2024, 87.5% e deficitit tregtar të vendit është realizuar në shkëmbim me Mbretërinë e Madhe, Kinën dhe Greqinë, dhe mandej vijon me Turqinë, Poloninë, Italinë, Serbinë, Bullgarinë e të tjera. Suficiti u arrit në shkëmbimin me Gjermaninë, Kosovën, Çekinë, Sllovakinë, Hungarinë dhe Spanjën.

Struktura valutore

Shikuar nga aspekti i strukturës valutore, 91.6% e shkëmbimit tregtar në vitin 2024 është realizuar në euro, ku krahasuar me vitin 2023 paraqet rënie për 0.3 p.p.. Në anën e eksportit dhe importit, valuata euro përfaqësohet përkatësisht me 94.2% dhe 89.8%, ku përfaqësimi i euros në eksport u zvogëlua me 0.8 p.p., ndërsa në import u rrit me 0.2 p.p. krahasuar me vitin 2023.

Tabela 2.2 Shkëmbim tregtar i Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas valutave/përlogaritë me MF-së													
Im porti	I-XII-2023					I-XII-2024					ndryshim absolut në vlerën e valutës	ndryshim i relativ në vlerën e valutës (%)	
valuta	sasia.000 t	im portinë valutë	kursi mesatar i denarë kundrejt valutave	im portinë denarë	strukt.në%	sasia.000 t	im portinë denarë	kursi mesatar i denarë kundrejt valutave	im portinë denarë	strukt.në%			
EYP	6031A	9985564739	612570	614681408646	89A	6012A	9934927337	612319	611314955396	89A	-50637402	-0,8	
USD	962P	1151168003	568426	65550499133	9A	603A	1115230582	568709	63424166823	9A	-35937421	-3,1	
GBP	2D	24145386	707835	1709123270	0Z	2A	23150058	726839	1682636485	0Z	-995729	-4,1	
EURO+USD+GBP	69967			681941031049	99A	6618A			676421758803	99A			
Vk eksporti	7014P				686299500351	100P	66397			680709145616	100P		-0,8
Burim: Enti i Shëtitërisë dhe Statistikave dhe BPRM-V													

Bazë: Enti Shtetëror i Statistikave dhe BPRM V-p

3.SEKTORI FISKAL

Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik

Në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024 realizimi i përgjithshëm i të hyrave buxhetore të Buxhetit të RMV-së është 305.622 milionë denarë, që paraqet 96.1% të vlerës së planifikuar për vitin 2024, përkatësisht rritje prej 10.3% krahasuar me të hyrat e realizuara buxhetore në krahasim me të njëjtën periudhë nga viti 2023. Në kuadër të të hyrave të përgjithshme janë realizuar 283.558 milionë denarë në bazë të të hyrave tatimore dhe kontributeve sociale, ku norma e realizimit është 99.7% nga vlera e planifikuar për vitin 2024, përkatësisht rritje prej 13.3% krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu, janë realizuar të hyra tatimore në vlerë të përgjithshme prej 176.081 milionë denarëve (realizim prej 100.2% nga vlera e planifikuar për vitin 2024), ndërsa kontributet janë realizuar në vlerë prej 105.668 milionë denarëve (rritje vjetore prej 14.1%, përkatësisht 100.4% e vlerës së planifikuar për vitin 2024). Në kuadër të të hyrave tatimore, ka rritje të të hyrave në bazë të: tatimit mbi të ardhurat personale për 16.9%, tatimit mbi fitimin për 19.2%, tatimit mbi vlerën e shtuar për 16.9%, akcizës për 7.0% dhe detyrimeve të importit me 14.9%, ndërsa të hyrat e tjera tatimore janë ulur për 73.5%. Gjatë kësaj periudhe, të hyrat jotatimore shënuan rritje prej 0.7%, ndërsa të hyrat kapitale shënuan rënie prej 10.6%, si dhe të hyrat nga donacionet e jashtme, të cilat shënuan rënie prej 58.8%.

Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024 arrin në 347.667 milionë denarë, që paraqet 95.8% të planit vjetor, përkatësisht rritje prej 9.1%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Njëkohësisht, janë realizuar shpenzime rrjedhëse në vlerë prej 318.969 milionë denarëve përkatësisht 98.0% nga vlera e planifikuar për tërë vitin, që paraqet rritje prej 19.0%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Rritje kanë shënuar edhe shpenzimet për pagat dhe kompensimet për 19.0%, në shpenzimet për mallra dhe shërbime me 8.6%, dhe në shpenzimet e interesit për 37.6%. Transfertat, të cilat janë kategoria më e madhe e shpenzimeve rrjedhëse, u rritën për 14.8%, të nxitura nga rritja e transfertave sociale me 14.3%, shpenzimet e shëndetësisë me 12.7%, dotacionet bllok dhe ato të destinuara për 11.2%, dhe subvencionet dhe transfertat për 21.3%. Shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerë prej 28.698 milionë denarëve dhe janë 34.1% më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Norma e realizimit të shpenzimeve kapitale në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024 krahasuar me vlerën e planifikuar është 76.8%.




Tabela 3.1. Realizimi i Buxhetit të RMV-së për periudhën janar - dhjetor të vitit 2024


	Rialokimi 2024	Jannar - dhjetor 2024		
	miliona denarë	miliona denarë	norma vjetore e rritjes (në %)	norma e realizimit
TË HYRA TË PËRGJITHSHME	318.151	305.622	10,3%	96,1%
Tatime dhe kontribute	284.469	283.558	13,3%	99,7%
Tatime	175.751	176.081	12,9%	100,2%
Tatimi mbi të ardhurat personale	31.542	31.852	16,9%	101,0%
Tatimi mbi fitimin	21.118	20.185	19,2%	95,6%
TVSH	78.458	81.465	16,3%	103,8%
Akciza	29.837	28.705	7,0%	96,2%
Detyrime të importit	13.556	12.917	14,9%	95,3%
Të hyra të tjera tatimore	1.240	957	-73,5%	77,2%
Kontribute	105.212	105.668	14,1%	100,4%
Të hyra jotatimore	22.541	16.988	0,7%	75,4%
Të hyra kapitale	3.240	1.851	-10,6%	57,1%
Donacione të jashtme	7.900	3.225	-58,8%	40,8%
Të hyra nga huatëë e arkëtuara	0	0	/	/
SHPENZIME TË PËRGJITHSHME	362.816	347.667	9,1%	95,8%
Shpenzime rrjedhëse	325.443	318.969	16,0%	98,0%
Paga dhe kompensime	44.361	43.889	19,0%	98,9%
Mallra dhe shërbime	26.043	22.923	8,6%	88,0%
Transferta	237.408	234.345	14,8%	98,7%
Transferta sociale	173.432	170.203	14,3%	98,1%
SPIMV	106.615	104.997	16,5%	98,5%
Kompensimi financiar për personat e papunësuar	2.926	2.653	9,1%	90,7%
Ndihmë sociale	15.314	14.761	6,4%	96,4%
Mbrojtje shëndetësore	48.576	47.792	12,7%	98,4%
Transferta të tjera	61.546	61.784	16,5%	100,4%
Interesi	17.632	17.812	37,6%	101,0%
Shpenzime kapitale	37.374	28.698	-34,1%	76,8%
SALDO BUXHETORE	-44.666	-42.045	1,4%	94,1%



Grafiku 3.1. Struktura e të hyrave të tjera tatimore të realizuara, janar – dhjetor 2024




Grafiku 3.2. Struktura e shpenzimeve të realizuara sipas klasifikimit ekonomik, janar – dhjetor 2024



Deficiti buxhetor i RMV-së në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024 është realizuar prej 42.045 milionë denarëve, që paraqet 4.4% të PBB-së e projektuar për vitin 2024, përkatësisht 94.1% të planit vjetor.


Grafiku 3.3. Deficiti buxhetor, të dhënat kumulative (mil. denarë)



Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë

Në vijim është dhënë pasqyra e shpenzimeve buxhetore për shfrytëzuesit më të mëdhenj buxhetorë. Në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë ka realizuar 67.695 milionë denarë ose 99.4% nga buxheti i përgjithshëm për vitin aktual. Po ashtu, pjesa më e madhe (68.6%) e shpenzimeve janë të destinuara për transferta rrjedhëse në fondet jashtëbuxhetore, për të cilat janë shpenzuar 46.411 milionë denarë përkatësisht 99.9% nga mjetet e parapara për vitin 2024. Zëri i dytë më i rëndësishëm i shpenzimeve janë

Grafiku 3.4: Struktura e shpenzimeve sipas shfrytëzuesve buxhetorë dhe ndarjeve (dhjetor 2024)





përfitimet sociale, me pjesëmarrje prej 21.4% në shpenzimet e përgjithshme dhe për këtë qëllim janë realizuar 99.6% (14.496 milionë denarë) nga planifikimi për vitin 2024.

Në periudhën e analizuar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka realizuar mjete buxhetore në vlerë prej 39.351 milionë denarëve, që është 96.5% e buxhetit të përgjithshëm për vitin 2024. Pjesa më e madhe e shpenzimeve (57.1%) paraqesin transferta rrjedhëse në NJVL, për të cilat janë shpenzuar 22.452 milionë denarë, përkatësisht 99.9% e mjeteve të përgjithshme të planifikuara. Pagat dhe kompensimet janë zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 19.7%, për të cilat janë shpenzuar 7.754 milionë denarë, përkatësisht 98.7% e mjeteve të përgjithshme të planifikuara.

Në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024, Ministria e Punëve të Brendshme ka realizuar gjithsej 15.054 milionë denarë, që paraqet 98.4% të buxhetit vetanak për vitin 2024. Zëri më i theksuar i shpenzimeve janë pagat dhe kompensimet me pjesëmarrje prej 64.9%, për të cilat janë shpenzuar 9.762 milionë denarë ose 100.0% nga vlera e planifikuar. Zëri i dytë më i rëndësishëm janë mallrat dhe shërbimet me pjesëmarrje prej 19.6%. Për këtë qëllim janë realizuar 2.955 milionë denarë përkatësisht 94.1% nga plani vjetor.

Në këtë periudhë Agjencia e Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (APFBZHR) ka realizuar 10.008 milionë denarë, që paraqet 96.9% të mjeteve të planifikuara për vitin aktual. Për subvencionet dhe transfertat, të cilët janë pjesëmarrës me vlerë 92.0% në shpenzimet e përgjithshme, me ç'rast janë realizuar 98.3% nga mjetet e planifikuara për tërë vitin, përkatësisht 9.206 milionë denarë.

Në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024, Ministria e Mbrojtjes ka realizuar 16.649 milionë denarë, që është 93.7% nga buxheti i përgjithshëm për këtë vit. Pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet e kanë pagat dhe kompensimet me 37.8%, për atë qëllim realizimi arrin në 6.288 milionë denarë (99.9% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara për vitin aktual). Shpenzimet kapitale me pjesëmarrje prej 26.8% nga shpenzimet e përgjithshme dhe për këtë zë janë shpenzuar 4.468 milionë denarë, përkatësisht 84.3% nga mjetet e përgjithshme të parashikuara.

Në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka realizuar gjithsej 4.368 milionë denarë, pikërisht 98.3% nga mjetet e planifikuara për vitin 2024. Po ashtu, subvencionet dhe kompensimet përbëjnë 64.3% nga shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor dhe janë realizuar në vlerë prej 2.810 milionë denarëve (98.8% nga mjetet e planifikuara).

Në periudhën e analizuar, Ministria e Shëndetësisë ka shpenzuar mjete buxhetore në vlerë prej 7.935 milionë denarëve përkatësisht 96.3% nga buxheti i përgjithshëm për vitin 2024. Pjesën më të madhe në shpenzime e kanë transfertat rrjedhëse në fondet jashtëbuxhetore me 51.4%, për të cilat janë shpenzuar 4.080 milionë denarë ose 100.0% nga mjetet e ndara për vitin 2024. Zëri i dytë më i theksuar janë mallrat dhe shërbimet me realizim prej 3.011 milionë denarëve (93.2% nga sa është planifikuar për vitin) dhe pjesëmarrje me 37.9% në shpenzimet e përgjithshme.

Në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024, Ministria e Transportit ka realizuar mjete në vlerë prej 8.504 milionë denarëve, që është 81.9% e buxhetit të përgjithshëm për vitin aktual. Realizimi i shpenzimeve kapitale si zë kryesor është 86.0% nga mjetet e përgjithshme të realizuara të këtij shfrytëzuesi buxhetor (7.312 milionë denarë ose 80.3% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara).

Në këtë periudhë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave ka realizuar mjete në vlerë prej 1.575 milionë denarëve, që paraqet 91.9% nga vlera e planifikuar për vitin 2024. Pagat dhe kompensimet (644 milionë denarë) janë zëri më i theksuar në shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor me pjesëmarrje prej 40.9%, ndërsa janë realizuar 99.2% nga të planifikuarat. Shpenzimet kapitale përbëjnë 21.4% nga shpenzimet e përgjithshme, ndërsa realizimi për këtë qëllim është 338 milionë denarë ose 93.8% nga buxheti i përgjithshëm për këtë qëllim.

Të dhënat e detajuara për secilin shfrytëzues buxhetor janë paraqitur në shtojcën statistikore në linkun në vijim (<http://finance.gov.mk/levizjet-ekonomike-afatshkurtra-ked-me/>).



4. SEKTORI SOCIAL




Personat e sapopunësuar dhe personat e regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit

Në muajin dhjetor të vitit 2024, në Agjencinë e Punësimit janë regjistruar gjithsej 191.468 marrëdhënie pune të sapokrijuara. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, numri i përgjithshëm i personave të sapopunësuar është ulur për 8.8%.

Nga numri i përgjithshëm i personave të sapopunësuar, janë të punësuar me kohë të pacaktuar, ndërsa pjesa tjetër me kohë të caktuar dhe për kryerjen e punëve sezonale. Nga numri i përgjithshëm i marrëdhënieve të sapokrijuara të punës, në muajin dhjetor të vitit 2024, 10.5% janë nga evidenca e personave të papunësuar.

Numri i përgjithshëm i personave të papunësuar, në muajin dhjetor të vitit 2024 është 140.946, nga të cilët 96.828 janë kërkuesë aktivë të punës, ndërsa 44.118 janë pjesa tjetër e personave të papunë. Në bazë vjetore, numri i përgjithshëm i personave të papunë është ulur për 7.7%, ndërsa duke filluar nga muaji maj i vitit 2021, ai shënoi rënie vjetore të vazhdueshme. Krahasuar me muajin nëntor të vitit 2024, numri i të papunëve është ulur për 593 persona.

Pjesa më e madhe e personave aktivë të papunë (58.9%) janë persona që jetojnë në qytet, ndërsa sipas strukturës gjinore 47.9% janë meshkuj. Sipas shkallës së arsimit, pjesa më e madhe e personave të papunë, përkatësisht 69.0% kanë arsim të mesëm jo të plotë ose më pak se aq, 23.6% me arsim të mesëm të përfunduar, ndërsa 7.4% me arsim të lartë ose më të lartë.





Analizuar sipas strukturës së moshës, 49.7% e të papunëve bëjnë pjesë në grupin e moshës madhore nga 25 deri 49 vjeç. Sipas kohës së pritjes së punësimit, 60.3% e personave të papunë presin të punësohen për 1 deri në 7 vjet, ndërsa 13.5% presin 8 vjet ose më shumë.

Pagat




Sipas raportit të Entit Shtetëror të Statistikave, paga/neto mesatare nominale në muajin nëntor të vitit 2024 ishte 41.999 denarë dhe shënoi rritje vjetore prej 9.5%, ndërsa krahasuar me muajin tetor të vitit 2024 ajo ishte më e ulët për 0.3%. Rritje më të madhe të pagës/neto mesatare krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023 u shënuan në sektorët në vijim: art, argëtim dhe rekreacion (15.3%), transport dhe deponim (12.7%), industri e përpunimit (11.2%). Në muajin nëntor të vitit 2024, pagat reale shënuan rritje vjetore prej 5.0%.

Paga mesatare neto më e lartë është paguar në muajin nëntor të vitit 2024 në sektorin e informacionit dhe komunikimit (77.475 denarë), me ç'rast vlera më e lartë të pagës neto është paguar në veprimtarinë e programimit kompjuterik, konsultimeve dhe veprimtarive të ndërlidhura (96.576 denarë), më pas ndjekin veprimtaritë financiare dhe veprimtaritë e sigurimve me 57.443 denarë, sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të koindicionuar me 53.418 denarë dhe sektori i minierave dhe gurorëve me 49.924 denarë.

Paga mesatare nominale bruto në muajin nëntor të vitit 2024 ishte 63.154 denarë dhe krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2023 ka rritje për 9.6%, ndërsa në bazë mujore ajo është më e ulët për 0.4%. Rritja më e ulët e pagës mesatare bruto në muajin nëntor të vitit 2024, krahasuar me muajin nëntor të vitit 2023 u shënuan në sektorët: arti, argëtimi dhe rekreacioni (15.4%), transporti dhe deponimi (12.3%) dhe industria e përpunimit (11.4%).

Pensionet

Në muajin dhjetor të vitit 2024, në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor janë evidentuar 340.028 pensionistë. Në muajin shtator të vitit 2024 u ndryshua Ligji i Sigurimit Pensional dhe Invalidor, ku sipas të cilit, më datën 01.10.2024 kishte rritje lineare për të gjitha llojet e pensioneve për 2.500 denarë. Nga numri i përgjithshëm i pensionistëve, 71.2%





janë shfrytëzues të pensionit të pleqërisë ose 245.744 pensionistë, 21.4% pensione familjar ose 73.389 pensionistë dhe 7.4 pensione invaliditeti ose 25.445 pensionistë.

Pensioni mesatar në muajin dhjetor të vitit 2024 është 23.774 denarë, ose 17.8 % më i lartë se muaji i njëjtë i vitit 2023⁴. Rritja e pensioneve, ndër të tjera, vjen si rezultat i harmonizimit të pensioneve në muajin mars, sipas metodologjisë që parasheh harmonizimin e pensioneve me model të kombinuar prej 50% rritje të pagës mesatare dhe 50% rritje të kostos së jetesës, sipas të dhënave zyrtare të ESHS-së. Sipas kësaj metodologjie, duke filluar nga muaji mars i vitit 2022, harmonizimi kryhet dy herë në vit, respektivisht në muajt mars dhe shtator.

Raporti i pensionit mesatar me pagën e paguar mesatare në muajin nëntor të vitit 2024 (të dhënat e fundit në dispozicion) është 56.6%.

Pensioni mesatar i pleqërisë në muajin dhjetor të vitit 2024 është 25.404, pensioni mesatar invalidor është 21.301 denarë, ndërsa pensioni mesatar familjar 19.200 denarë. Për pagesën e pensioneve këtë muaj janë harxhuar 7.945 milionë denarë, që paraqet 49.2% nga transfertat e përgjithshme sociale.

Tabela 4.1 Të dhënat e të ardhurave pensionale për muajin dhjetor të vitit 2024			
Shfrytëzuesit e pensionit	numër	struktura	pensioni mesatar
pleqërie	245.744	71,2%	25.404,00
invaliditeti	25.445	7,4%	21.301,00
familjar	73.839	21,4%	19.200,00
Gjithsej	345.028	100,0%	23.774,00
Shfrytëzuesit në minimum.			
pensionet bujqësore	37		13.429,00
Shfrytëzuesit e pensioneve ushtarake			
	729		32.581,00
Gjithsej	345.794		23.785,00
Burimi: Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut			

5. SEKTORI MONETAR FINANCIAR

⁵ Gjatë përllogaritjes së pensionit mesatar nuk janë përfshirë pensionet ushtarake dhe bujqësore.



Në muajin dhjetor të vitit 2024, Banka Popullore e uli normën bazë të interesit për 0.25 p.p., në nivel prej 5.55%, pasi filloi ta zvogëlonte atë nga muaji shtator. Vendimi për lehtësimin e politikave monetare bazohet në vlerësimin e inflacionit në zhvillimet më të fundit të treguesve kryesorë makroekonomikë dhe në lëvizjet e favorshme në tregun devizor. Ky zvogëlim është në përputhje me politikën monetare të BQE-së, e cila filloi uljen e normave të interesit në muajin shtator të vitit 2024.

Në muajin dhjetor të vitit 2024, Banka Popullore i ka mbajtur depozitat njëditore dhe shtatëditore të disponueshme për 0.25 p.p., respektivisht në nivel 3.95% dhe 4.00%



Paratë primare

Në muajin dhjetor të vitit 2024, paratë primare⁵ janë rritur për 12.9% në nivel mujor. Rritja e parave primare vjen si pasojë e rritjes së mjeteve të përgjithshme likuide për 18.3% dhe parave të gatshme në qarkullim për 7.8%.

Në muajin dhjetor të vitit 2024, paratë primare janë rritur për 24.2% në nivel vjetor, si pasojë e parave të gatshme në qarkullim dhe mjeteve të përgjithshme likuide, respektivisht për 16.0% dhe 33.0%.

Potenciale i depozitave⁶

Në muajin dhjetor të vitit 2024, depozitat e përgjithshme në banka janë rritur për 5.3% në nivel vjetor. Analiza sektoriale tregon se krahasuar me muajin e kaluar depozitat familjare dhe depozitat e ndërmarrjeve janë rritur respektivisht për 3.9% dhe 8.7%.



Nga aspekti valutor, në muajin dhjetor të vitit 2024, krahasuar me muajin parapark, depozitat vendore dhe valutat e huaja regjistruan rritje, respektivisht prej 7.2% dhe 2.5%.

Në muajin dhjetor të vitit 2024, potenciali i përgjithshëm i depozitave regjistroi rritje prej 12.4% në nivel vjetor. Analizuar sipas valutave, depozitat në valutë vendore janë rritur për 17.2%, ndërsa depozitat në valutë të huaj për 6.1%.

Nga aspekti sektorial, depozitat e ndërmarrjeve kanë regjistruar rritje për 9.2% në nivel vjetor, ndërsa depozitat familjare kanë regjistruar rritje prej 13.8%.

Tabela 5.1. Potenciali i depozitave dhe kredive në sektorin privat

⁵ Paratë primare përllogariten si shumë e parave të gatshme në qarkullim (përfshirë edhe paratë e gatshme në arkë), rezervës së detyrueshme në denarë dhe në deviza dhe tepricës së mjeteve likuide mbi detyrimin për rezervën e detyrueshme.

⁶ BPRMV-ja publikoi të dhënat nga statistikave monetare, statistikave të institucioneve të tjera financiare dhe statistikave për normat e interesit, sipas metodologjisë së re. Ndryshimet metodologjike u realizuan për shkak të harmonizimit me rekomandimet e Manualit të sapopublikuar dhe Udhëzuesit të statistikave monetare dhe financiare të FMN-së nga viti 2016 (MFSMCG – IMF, 2016) dhe Misionit teknik të FMN-së në fushën e statistikave monetare dhe financiare në BPRMV të vitit 2015.



Potenciali i depozitave dhe kredive në sektorin privat (dhjetor 2024)	Në miliona denarë	Ndryshimi mujor	Ndryshimi vjetor
Potenciali i depozitave	600.382	5,3%	12,4%
Sipas valutës:			
Denarë	356.412	7,2%	17,2%
Valutë e huaj	243.971	2,5%	6,1%
Sipas afatizimit:			
Afatshkurtër	223.165	4,0%	3,4%
Afatgjatë	147.382	1,3%	25,4%
Kreditë në sektorin privat	494.449	2,7%	11,2%
Sipas valutës:			
Denarë	304.158	3,1%	18,0%
Valutë e huaj	190.291	2,1%	1,8%
Sipas afatizimit:			
Afatshkurtër	75.975	9,2%	13,4%
Afatgjatë	402.528	1,9%	10,9%

Burimi: BPRMV

Sipas afatizimit, depozitat afatshkurtra u rritën në nivel vjetor u rritën për 3.4%, ndërsa depozitat afatgjate u rritën për 25.4%.

Struktura valutore e depozitave vazhdon edhe më tej të mbetet stabile, me ç'rast pjesëmarrja në depozita në valutë vendore dominon në bazën e depozitave, ku edhe këtë muaj pjesëmarrja ka shënuar rritje dhe është 59.4%.

Kreditë bankare

Në muajin dhjetor të vitit 2024, kreditë e përgjithshme bankare në sektorin privat janë rritur për 2.7% në nivel mujor, në kushtet e rritjes së kredimitit të familjeve dhe ndërmarrjeve, respektivisht për 1.1% dhe 4.4%

Nga aspekti i valutor, në nivel mujor kreditë në denarë shënuan rritje për 3.1%, ndërsa kreditë devizorë kanë regjistruar rritje prej 2.1%.

Në bazë vjetore, në muajin dhjetor të vitit 2024, kreditë e përgjithshme janë rritur për 11.2%, në kushtet e rritjes së kredive të ndërmarrjeve dhe kredive ndaj familjeve, përkatësisht për 13.9% dhe 8.8%. Kreditë në valutën vendore janë rritur për 18.0%, ndërsa kreditë në valutë të huaj kanë regjistruar rritje për 1.8%.

Nga aspekti i afatizimit, kreditë afatgjate shënuan rritje vjetore prej 10.9%, ndërsa kreditë afatshkurtra prej 13.4%.



Normat e interesit të depozitave bankare

Në muajin dhjetor të vitit 2024, norma e përgjithshme e interesit të kredive u ul për 0.06% p.p krahasuar me muajin paraprak dhe ajo ishte 5.30%. Norma e interesit të kredive në denarë u ul për 0.09 p.p., dhe është 5.71%, ndërsa norma e interesit të kredive divizore regjistroi rënie prej 0.05 p.p dhe është 4.70%.

Në muajin dhjetor të vitit 2024, norma e përgjithshme e interesit të depozitave u rrit për 0.05% p.p., krahasuar me muajin paraprak dhe është 2.17%.



Norma e interesit të depozitave në denarë u rrit për 0.07 p.p., dhe është 2.70%, ndërsa depozitat devizore për 0.02 p.p., dhe është 1.68%.

Norma e interesit e kredive të sapoaprovuara në denarë shënon 4.62%, ndërsa të kredive të sapoaprovuara devizore 3.94%. Normat e interesit të depozitave të sapomiratuara në denarë dhe në deviza janë përkatësisht 3.19% dhe 2.19%.

Tregu i kapitalit

Në tregun e kapitalit, qarkullimi i përgjithshëm në bursë në muajin dhjetor të vitit 2024 u ul për 9.4% në nivel mujor, si rezultat i rritjes së qarkullimit të transaksioneve bllok për 5.4% dhe rritjes së qarkullimit nga tregtia klasike për 19.5%. Rënia vjen për faktin se në muajin dhjetor, ndryshe nga muaji paraprak, nuk u regjistruan ankande publike në bursë.

Qarkullimi i përgjithshëm në bursë në muajin dhjetor të vitit 2024 arriti në 2.302 milionë denarë, që paraqet rritje prej 605.5% në nivel vjetor.



Në fund të muajit dhjetor të vitit 2024, Indeksi i Bursës së Maqedonisë IBM-10 arriti në 10200,9 pikë indeksi, me ç'rast në nivel mujor u rrit për 12.0% dhe krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, indeksi u rrit për 66.8%.

Rezervat devizore

Në fund të muajit dhjetor të vitit 2024, vlera e rezervave devizore bruto është 5.020,03 miliona euro dhe krahsuar me muajin paraprak u rrit për 2.0%, ndërsa krahsuar me muajin dhjetor të vitit 2023 rezervat devizore u rritën për 10.6%.